

VENDIM
Nr. 371, datë 1.6.2022

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA DREJTORIA E
PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TEK PROKURORIA E PËRGJITHSHME, TË
PASURISË NR. 25/48-N4, ZONA KADASTRALE 2315, KUKËS, ME SIPËRFAQE 365
m², SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
ARKIVAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, date 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Prokuroria e Përgjithshme, të pronës me emërtimin “Dega arkivore Kukës”, me nr. pasurie 25/48-N4, zona kadastrale 2315, Kukës, e llojit njësi, me sipërfaqe 365 m², në katin e tretë teknik, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Prokuroria e Përgjithshme dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

7




PLANIMETRIA E OBJEKTIT:
 "ZYRAT E ARKIVIT SHTETEROR VENDOR" KUKES

SHKALLA 1 : 100

Adresa: Godina e ``Ish Komitetit te Partise``Kati Trete

Sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore	365 M2
Nga kjo Kafaz shkallësh	20 M2
Sipërfaqja gjithsej	345 M2



MIRATOHET :

Porositësi: Drejtori i Arkivit Shtetëror Vendor
KUKES

Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave

Punoi:

Ing. Dritan DOMI
Top. Skender LACI

Miftar NERGUTI

Ing. Ramadhan MUJJA

Ing. Dritan DOMI
Top. Skender LACI
Kujdes Nr. 10392
ALBANIA